

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikanten Floriana Grabovci, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. B nga Gj, për shkak të veprës penale **Vjedhje**, nga neni 325, par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr. 2173/2015, të datës 08.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 27.11.2017, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli këtë, ndërsa me datë 01.12.2017 përpiloi këtë :

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari B. B, nga babai A dhe nëna Sh lindur D, i lindur më datë ...në Z, jeton në Gj , në rrugën..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë dhe nuk zhvillohen procedura të tjera ndaj të njëjtit.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse, në me datën 14.08.2015, rreth orës 22:32 minuta ,në Gjilan ,te qendra tregtare ETC, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete në këtë qendër merr kasën me pare metalike në shumë prej 60 euro ( e destinuar për ndihmë për persona me nevoja të veçanta), dhe me kasën e vjedhur largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush.

-me çka ka kryer vepër penale **Vjedhja**, nga neni 325, par. 1 të KPRK-së, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

**E G J Y K O N  
M E D Ë N I M M E K U S H T**

Të akuzuarin B. B, me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh** dhe **Dënim Gjore**, në shumën prej **150 (njëqindpesëdhjetë) €**, cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1(një) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **20 (njëzetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan,- Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr. 2173/2015, të datës 08.12.2015, kundër të akuzuarit B. B, për shkak të veprës penale **Vjedhja**, nga neni 325,par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Prokurorja Rozelida Manastiri , në fjalën përfundimtare deklaroi se në këtë çështje penalo-juridike i akuzuari B. B, e pranoi fajësinë për kryerjen e veprës penale, e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore, i akuzuari në fjalë fajësinë e pranon me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë pasi që nga ana e gjykatës u njoftua lidhur me pasojat dhe favoreet e pranimit të fajësisë . Meqë është vërtetuar gjendja faktike, kjo, si prokurore e kësaj çështje penalo juridike mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban, dhe kërkon nga gjykata që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj sanksionin e paraparë ligjor. Gjykatës i propozon para se të përcaktohet për llojin dhe lartësinë t' ia shqiptojë sanksionet adekuate penale, në mënyrë

*që me shqiptimin e sanksionit penal të arrihet vetë qëllimi i dënimit dhe njëherit dënimi i shqiptuar të ndikon në risocializimin e tij në mënyre që i akuzuari në të ardhmen mos të kryej vepra të ngjashme e as vepra të tjera penale.*

*I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi se është penduar, se i vie keq për këtë vepër penale, premtoi se në të ardhmen nuk do ta përsëris këtë vepër penale, andaj kërkon nga gjykata që ti shqiptoi një dënim sa më të butë që është e mundur.*

*Pas përfundimit të procedurës, gjykatësja shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, dhe erdhi në përfundim se vërtetë i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, Vjedhja, nga neni 325, par. 1, të KPRK-së.*

*Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese mori sjelljet e mira të të akuzuarit në gjykatë ndërsa, si rrethanë rënduese, mori peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.*

*Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është bazuar në nenin 463 të KPPRK-ës.  
Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.  
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 31/16, më datë 01.12.2017**

**Praktikantja,  
Floriana Grabovci**

**Gjykatësja e vetme gjykuese,  
Luljete Shabani**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.